

VENDIM
Nr.40, datë 30.9.1998

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Hilmi Dakli	Anëtar i " "
Alfred Karamuço	Anëtar i " "
Hajredin Fuga	Anëtar i " "
Kristofor Peçi	Anëtar i " "
Kujtim Puto	Anëtar i " "
Sokol Sadushi	Anëtar i " "
Franc Jakova	Anëtar i " "

me sekretare Arta Palushi, më datë 6.7.1998 dhe 24.7.1998, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.28 që i përket:

KËRKUES: Shoqëria "Loxhal limited", përfaqësuar nga avokatja Liljana Ruli dhe Evelina Qirjako.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. Kolektivi punonjës i ëmbëltorës "Marsel Kashen", përfaqësuar nga avokat Besnik Kurti.
2. Kontrolli i Lartë i Shtetit, përfaqësuar nga zoti Arben Kraja dhe Vasillaq Peci.
3. Seksioni i financës pranë Bashkisë së Tiranës, në mungesë.

OBJEKTI: Deklarimi antikushtetues i vendimeve nr.2728, datë 9.4.1996 të Gjykatës së Rrethit - Tiranë, të vendimit nr.3642, datë 1.6.1996 të Gjykatës së Apelit - Tiranë dhe vendimit nr.1740, datë 7.11.1996 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Kasacionit.

Kërkuesi ka parashtruar si shkaqe ligjore për antikushtetushmërinë e vendimeve të sipërpërmendura cenimin e neneve 27 dhe 38 të ligjit "Për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut" dhe konkretisht:

1. Shërbimi i Kontrollit të Shtetit nuk legjitimohej në ngritjen e padisë, sepse është mbështetur në një dekret të Presidentit të Republikës që nuk ka fuqi juridike;
2. Gjykata e Apelit ka vazhduar gjykimin e çështjes edhe pas heqjes dorë nga shtesa e objektit të padisë për shoqërinë "Loxhal";
3. Padia e Shërbimit të Kontrollit të Shtetit është parashkruar;
4. Vendimi i Gjykatës së Kasacionit ka ndryshuar krejtësisht shkakun dhe objektin e padisë, nga pavlefshmëri kontrate në njohje bashkëpronësie;
5. Shërbimi i Kontrollit të Shtetit nuk ka mbrojtur interesat e shtetit, por të personave privatë;
6. Gjykata e Kasacionit ka vendosur që shoqëria "Loxhal" të lirojë dhe dorëzojë lokalin të gjithë personave të tretë dhe të paditurve, pa deklaruar pavlefshmërinë e kontratës etj.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi shpjegimet e përfaqësuesve të kërkuarit dhe të përfaqësuesit të subjekteve të interesuara,

VËREN:

Të tre vendimet gjyqësore duhet të shpallen antikushtetuese, sepse janë rrjedhojë e shkeljeve flagrante të nenit 27 dhe 38 të ligjit kushtetues, që e kanë bërë procesin ligjor të parregullt.

Shërbimi i Kontrollit të Shtetit për ngritjen e padisë në gjykatë është mbështetur në dekretin e Presidentit të Republikës nr.203, datë 5.6.1992 "Mbi deklarinë dhe verifikimin e fitimeve të realizuar". Në kundërshtim me nenin 28, pika 19 dhe 29 të ligjit "Për dispozitat kryesore kushtetuese", ky dekret nuk është miratuar në Kuvendin Popullor, (siç rezulton nga shkresa nr.2247/1, datë 31.8.1998 e Kuvendit Popullor) dhe njëkohësisht nuk është kundërfimosur nga Kryeministri apo ministri përkatës. Për rrjedhojë, dekreti konsiderohet si një akt juridik absolutisht i pavlefshëm dhe pa asnjë fuqi juridike. Ngritja e kërkesë-padisë nga Shërbimi i Kontrollit të Shtetit duke u mbështetur në një dekret të Presidentit që nuk ka fuqi juridike, jo vetëm që e bën atë të pambështetur në ligj, por njëkohësisht cenon haptazi dhe rregullsinë e procesit gjyqësor. Vërtetë padia mban datën 20.6.1995,

por ligji nr.7949, datë 14.6.1995, i cili i jepte të drejtën e Shërbimit të Kontrollit të Shtetit të bënte padi në gjykatë, ka hyrë në fuqi më datë 1.8.1995.

Megjithëse, edhe vetëm për këtë shkelje, mjafton që vendimet e mësipërme të shpallen antikushtetuese, Gjykata Kushtetuese vëren se gjykatat kanë kryer edhe shkelje të tjera që e bëjnë procesin gjyqësor të parregullt.

Kështu në kundërshtim me nenin 118/3 të Kodit të Procedurës Civile të mëparshëm, i cili zbatohet për çështjen konkrete, Gjykata e Apelit, pas kërkesës për heqje dorë nga shtesa e objektit të padisë të Shërbimit të Kontrollit të Shtetit, nuk ka rrëzuar padinë, por padrejtësisht ka vazhduar gjykimin.

Kolegji Civil i Gjykatës së Kasacionit, duke cenuar parimin e përgjithshëm, sipas të cilit gjykata duhet të shprehet mbi gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet, ka ndryshuar shkakun dhe objektin e padisë, nga padi për pavlefshmëri të veprimit juridik në padi për njohje bashkëpronësie. Ai ka bërë bashkëpronar në këtë lokal ish-punonjësit në një kohë që ligji nuk ia njeh këtë të drejtë. Kolegji Civil i Gjykatës së Kasacionit ka vendosur që shoqëria "Loxhal" t'ua lirojë dhe dorëzojë lokalin personave të tretë dhe të paditurve, duke mos u shprehur në dispozitiv për pavlefshmërinë e kontratës. Jo vetëm kaq por Kolegji Civil i Gjykatës së Kasacionit, duke zgjidhur në mënyrë të menjëhershme pasojat, i ka mohuar blerësit, shoqërisë "Loxhal", pronësinë e objektit dhe nuk i ka dhënë mundësi të kërkojë kthimin e kundërvleftës përpara liritimit dhe dorëzimit të tij.

Të gjitha këto shkelje kanë cenuar hapur procesin gjyqësor duke i mohuar kërkuarit të drejtën e pronësisë, të cilën ai e ka fituar konform ligjit.

I gjithë procesi gjyqësor, që ka filluar me ngritjen e padisë nga Shërbimi i Kontrollit të Shtetit, dhe deri në vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Kasacionit është i parregullt në aspektin kushtetues. Për rrjedhojë dhe vendimet e Gjykatës së Rrethit - Tiranë, të Gjykatës së Apelit dhe të Kolegjit Civil të Gjykatës së Kasacionit duhet të shpallen antikushtetues dhe pa asnjë efekt juridik në kuptim të nenit 45, të ligjit nr.8373, datë 15.7.1998 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese".

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenin 24 të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 "Për disa shtesa e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese, me shumicë votash,

VENDOSI:

Shpalljen antikushtetues të vendimit nr.2728, datë 9.4.1996 të Gjykatës së Rrethit - Tiranë, të vendimit nr.3642, datë 1.6.1996 të Gjykatës së Apelit - Tiranë dhe vendimit nr.1740, datë 7.11.1996 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Kasacionit.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.